



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2018, ora 08:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Seancë dëgjimore me grupe interesi lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Visar Rexhepi – biznesmen

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Sot kemi një seancë dëgjimore lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, dt. 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Para se të kalojmë tek i ftuari, a keni ndonjë gjë për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nuk keni.

Miratohet procesverbali.

Pa humbur kohë, dua t’ia jap fjalën zotit Rexhepi, i cili është biznesmen dhe përfaqëson një fashë të caktuar të përpunimit dhe prodhimit të plastikës.

Mirë se erdhët, zoti Visar!

Shkurtimisht na thoni: çfarë lloj biznesi është? Kur është hapur? Cilat janë problematikat në lidhje me ndryshimet në paketën fiskale?

Urdhëroni!

Visar Rexhepi – Përshëndetje!

Si subjekt ne jemi hapur që në vitin 1992 nga i ndjeri Petrit Rexhepi, babai im. Aktualisht kemi investuar në një fabrikë të prodhimit të plastikës, në një kabanon që ndodhet 7 kilometra jashtë autostradës. Investimi total deri tani vetëm për kabanonin është mbi 500 euro; investimet në makineri brenda vitit që shkoi dhe sivjet kapin shifrën mbi 270 mijë euro; investimet në lëndën e parë që na duhet për prodhim kapin shifrën 250 mijë euro. Kështu që flasim për një investim që shkon rreth 1 milion euro në total.

Në bazë të ligjit të, ri për shkak se ne 90% e prodhimeve tona janë për eksport, për shkak të penalteteve të reja që do të vihen, e kemi të pamundur të vazhdojmë eksportin si me Italinë, ashtu edhe me Greqinë dhe do të jemi të detyruar të marrim dy masa: ose ta lëvizim fabrikën drejt vendeve të rajonit, ku nuk paguhen këto taksa dhe janë inekzistente, por, përveç kësaj, kanë edhe lehtësira të tjera fiskale rreth prodhimit të kësaj natyre. Ne siç jemi importues, jemi edhe eksportues dhe problemi është tek TVSH-ja, që nuk na rimburohet për shkak se na zbritet në fund të çdo muaji.

Aktualisht, jemi në një gjendje pozitive me TVSH-në në shtet, pra pak a shumë janë lekë tonat që rrinë në bankën e shtetit. Kësaj po t’i shtojmë edhe një rimbursim të ri, na bie që mbi 50% e kostos së produktit tonë të rrijë në bankat e shtetit, që as shteti nuk i përdor dot, por edhe ne nuk i përdorim dot. Domethënë janë një paralizë qoftë për bizneset, qoftë për shtetin.

Unë dua të propozoj diçka për punën e lëndës së parë, sepse nuk ka sens të hiqet lënda e parë nga produktet njëpërdorimshme dhe nga produktet disapërdorimshme, sepse është shumë e vështirë për t'u përcaktuar. Në kallëpet e prodhimit nuk i ndërrojmë dot, sepse brenda të njëjtës ditë prodhojmë edhe prizat e korrentit, prodhojmë edhe lugët e plastikës, edhe bidonët ujit, edhe çdo gjë. Pra, prodhojmë gjëra që janë njëpërdorimshme, por edhe gjëra shumëpërdorimshme. Prandaj nuk bën sens pse duhet të jetë kjo lloj takse sidomos te prodhuesit.

Në qoftë se dëshironi që të bëhet një taksë për shkak të ndotjes së mjedisit, ne e kuptojmë dhe duhet të vihet një taksë për ndotjen e mjedisit, por gjithmonë duhet ruajtur një raport. Në qoftë se ne si subjekt 80%-90% të produktit të lëndës së parë që marrim e eksportojmë, nuk kemi pse të tato kemi ose të vihen taksa në këtë 80%-90%, sepse ne konkurrojmë në një treg rajonal, nuk konkurrojmë me veten tonë. Unë që të jem konkurrent me Bullgarinë, me Italinë dhe me Greqinë, duhet patjetër që këto taksa të mos ekzistojnë. E kam të pamundur të eksportoje me këto taksa aktuale që keni propozuar.

Eduard Shalsi - Këto ditë edhe ne vetë jemi përpjekur të kuptojmë kontekstin. Ka pasur një taksë 100 lekë për kilogram, apo jo?

Visar Rexhepi – Për ambalazhet njëpërdorimshme të plastikës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për produktet, vetëm për ambalazhet njëpërdorimshme të plastikës. Domethënë, kanë pasur akcizë kontenerët e plastikës, ndërsa luga, piruni, pjata dhe gota nuk kanë pasur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Edhe një herë.

Visar Rexhepi – Domethënë, çdo ambalazh plastik, i cili mbyllet dhe krijonte kuti, është subjekt për taksën 100 lekë, kurse çdo ambalazh që ka qenë i hapur, domethënë gota e ujit, pipa, pra çdo produkt i plastikës nuk ka pasur akcizë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Domethënë, ka qenë 100 lekë për kilogram, ndërkohë që bëhet 35 lekë për kilogram.

Visar Rexhepi – Po.

Eduard Shalsi – Ndërkohë, vendoset një taksë e re për lëndën e parë, që është 25 lekë, dhe është pengesa...

Visar Rexhepi – Jemi i vetmi vend që taksojmë lëndën e parë, sepse kryesisht lënda e parë përdoret për prodhim. Jemi i vetmi vend në rajon që taksojmë lëndën e parë.

Vullnet Sinaj – Kjo taksa, që është për ambalazhin, ju cenonte juve si prodhues, apo nuk hynte fare?

Visar Rexhepi – Jo, nuk ka cenonte si prodhues.

Eduard Shalsi – Pra, mbasi merrje lëndën e parë, cilat janë produktet që prodhon ti?

Visar Rexhepi – Ne prodhojmë: lugë plastike, pirunë plastikë dhe përzierësit e kafesë, janë disa shkopinj të vegjël plastikë.

Eduard Shalsi - Pra, këto janë produktet.

Visar Rexhepi – Po.

Eduard Shalsi - Ndërkohë, mbasi prodhoje, nuk paguaje 100 lekë?

Visar Rexhepi – Jo, për lugët dhe pirunjtë nuk paguajmë 100 lekë për kilogram, as në rast importi nuk kemi pasur dhe as në rast prodhimi nuk do të kemi.

Eduard Shalsi - Nuk ka pasur.

Besnik Baraj – Domethënë, në parim ajo duhet të kishte, pavarësisht se nuk ka pasur, sepse si ambalazh, si ajo që është njëpërdorimshme...

Rakip Suli – Zoti kryetar, me aq informacion sa kam, nuk ka rëndësi kompania se çfarë biznesi ka bërë, çdo produkt që ka ardhur nga importi, i ambalazhuar me plastikë, ka pasur një taksë 100 lekë. Nuk ka rëndësi thjesht emërtimi që ti merresh me këtë biznes, por çdo produkt që është importuar nga jashtë, që ka qenë i ambalazhuar mbi kaq kilogramë taksohet.

Vullnet Sinaj – Nuk ka lidhje me këta prodhuesit. Favorizimi është bërë për importuesit, jo për prodhuesit.

Eduard Shalsi - Ndërkohë, ju thoni që kjo nuk ka vend.

Visar Rexhepi – Aktualisht në Shqipëri asnjë nuk prodhon tasa të ambalazhit të plastikës ose mund të ketë shumë pak prodhues, që nuk janë lojtarë në treg.

Besnik Baraj – Ka një gjë, kur importonit dhe ishte ambalazh e paguanit taksën në doganë.

Visar Rexhepi - Po, e paguaja taksën në doganë.

Besnik Baraj – Ndërkohë, kur merrte granulë dhe prodhonte ambalazh në Shqipëri, e merrte në produkt, në shitje në Shqipëri.

Visar Rexhepi – Po, në qoftë se prodhoje ambalazh në Shqipëri, por unë nuk kam prodhuar ambalazh dhe nuk besoj se ka subjekte që prodhojnë.

Besnik Baraj – Flas në tërësi, por evazioni qëndronte këtu, ai që prodhonte ambalazh, nuk e deklaronte, thoshte e se ka çuar për tuba. Prandaj Ministria e Financave, për

shkak të këtij evazioni, kërkon që të vendoset një tarifë konstante në importin e lëndës së parë, që, sigurisht, penalizon zotin Visar dhe disa të tjerë.

Eduard Shalsi - Zoti Rexhepi, a keni ndonjë koment? Ministria e Financave ka shtruar si argument evazionin fiskal që bëhet në këtë sektor, me deklarime të ndryshme nga ato që prodhohen.

Visar Rexhepi - Për pjesën e evazionit fiskal, se kush e bën, nuk jam kompetent dhe nuk jetoj as këtu, që të di më shumë histori rreth tij. Unë mund të them për veten time që mbi 90% të produktit e kam për eksport. Çdo gjë është e deklaruar, mund t'i verifikoni shumë kollaj në fatura, që i deklaroj këtu dhe në Itali. Mund t'ju tregoj komunikimet me *email* rreth çmimeve, sasisë që dërgojmë dhe sasisë që na vjen.

Eduard Shalsi – Ju thatë: “Lënda e parë nuk taksohet në asnjë vend”.

Visar Rexhepi – Nuk taksohet në asnjë vend lënda e parë. Përgjithësisht çdolloj lënde e parë nuk taksohet, sepse pezullon prodhimin, në momentin që pezullon prodhimin, humb sensin e ekonomisë.

Besnik Baraj – Ndërkohë, Ministria e Financave thotë: “Ai që eksporton do e marrë këtë taksë kur del”. Por me të drejtë Visari thotë, siç nuk na kthehet TVSH-ja, ashtu nuk do të na kthehet edhe kjo tjetra. Problemi është se nuk zbatohet ligji nga Ministria e Financave ose nga doganat në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Unë them se janë dy probleme: një është me ndërmarrjet, si kjo e zotit Visar, që eksportojnë, të cilat të gjithë produktin e lëndës së parë që importojnë e bëjnë 90% eksport dhe ju ndikon në çmimin e konkurrencës së tregut në Ballkan, ku ai ka tregun e tij të shitjes. Një tjetër problem janë prodhuesit shqiptarë që nuk kanë eksport, por që prodhojnë për brenda vendit. Në këtë rast pse duhet t'i penalizojmë prodhuesit shqiptarë me një taksë të tillë dhe të lejojmë importin, pra të na vijnë produkte nga importi për në Shqipëri? Ne më mirë favorizojmë prodhuesit tanë. Prodhojmë këtu, të punësohen sa më shumë njerëz, pra të mos ikin lekët jashtë, është shumë e thjeshtë logjika.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Bici!

Më pas fjalën e ka zoti Beqaj.

Dritan Bici - Në vend që të mbështesim prodhimin vendas, siç është edhe rasti në fjalë, ne i krijojmë probleme këtij me këto lloj taksash që propozon Ministria e Financës. Evazioni fiskal është tjetër gjë, por ç'faj ka ky që të penalizohet. Ashtu siç e tha edhe zoti Sinaj, ne vuajmë ngaqë nuk po prodhojmë dot gjë, prodhojmë vetëm në bujqësi dhe vetëm eksportojmë ndonjë gjë nga bujqësia. Rasti në fjalë është për t'u mbështetur, sepse do të thotë

se edhe ne si shqiptarët prodhojmë dhe dalim në treg. Kështu që, mendoj se nuk përbën ndonjë gjë të madhe për ekonominë shqiptare dhe për buxhetin e Republikës së Shqipërisë në qoftë se hiqet kjo lloj takse.

Eduard Shalsi – Në fakt, zoti Besnik, në mos gaboj, kemi bërë një amendim për pjesën e eksportit.

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Në qoftë se mund të pyes për të saktësuar informacionin që ne kemi, na thonë se çmimi i granulatit është 145 lekë për kilogram.

Visar Rexhepi – Përgjithësisht po.

Ilir Beqaj - Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Visar Rexhepi – Jo, është shumë e lirë, 700 euro për ton është shumë poshtë, shkon mbi 1 mijë euro për ton.

Ilir Beqaj – Pak a shumë në prodhimet tuaja vetëm lënda e parë çfarë peshe zë në kosto?

Visar Rexhepi – Kryesisht, koston e mbulon lënda e parë, sepse pastaj punëtori normalisht...

Ilir Beqaj – Sa?

Visar Rexhepi – Mbi 70% të koston e mbulon lënda e parë. Ne si prodhues, sidomos në eksporte, me norma fitimi jemi diku nga 3% në 9%.

Ilir Beqaj – Po flas për kosto, jo për normën e fitimi.

Visar Rexhepi – Jo e kam fjalën sa ndikon ky 16%-20%, domethënë jemi komplet jashtë elasticitetit të biznesit për një periudhë të shkurtër.

Ilir Beqaj – E kuptova.

Atëherë, po e lëmë një moment eksportin, nëse kostoja e granulatit në produkt zë 70%, do të rritet kostoja e produktit total në qoftë se vendosim taksën 25 lekë me 12%.

Visar Rexhepi – Ne kemi nxjerrë një kosto pak më të saktë, është 16%-20%.

Ilir Beqaj – Kalimi i koston nga 145 lekë në 170 lekë ta rrit me 17%, po të jetë taksa 20 lekë, ta rrit 14% dhe po të jetë taksa 15 lekë, ta rrit 10,5% lëndën e parë. Meqenëse të zë 70%, 10% dhe 7,5%, nëse jemi me 25, 20 apo 15.

Eduard Shalsi – Po bën 3 skenarë çmimesh?

Ilir Beqaj – Po, tre skenarë takse.

Një taksë është propozuar 25, por po ta kemi 20 apo 15, do të ndikojë në koston e prodhimit plus 12%, plus 10%, plus 7,5%.

Duhet të keni parasysh një gjë: nga na lindi ky problem? Ky problem lindi se në momentin që ne kemi regjime fiskale të ndryshme për prodhimin dhe për importin, na turret BE-ja. Ky problem nga kjo ka dalë, sepse ne kemi pasur taksën e ambalazhit dhe importin 100 lekë në prodhim vendas 1 lekë, edhe ajo na tha se jemi goxha të disporcionuar, na i bëjnë këtë muhabet tek akciza e birrës, na e kanë bërë tek barnat dhe na kanë bërë në shumë gjëra. MSA-ja, që kemi firmosur bashkërisht të gjithë, me vullnet të lirë, nuk na i lë shumë këtë sovranitetin kombëtar për prodhim vendi me kështu instrumentesh, thotë përdor forma të tjera. Çfarë do të ndodhë? Në qoftë se produkti do të vijë i gatshëm nga importi, Besniku me të drejtë thotë: “Për impaktin e plastikës në mjedis, duhet ta taksojmë”, apo jo, Besnik në parim? Në qoftë se ky prodhimi, që do të vijë nga importi, do të taksohet, ndërsa ti po ta prodhosh në vend, nuk do e taksosh, do të vijë vitin tjetër një i BE-së...

Visar Rexhepi – Edhe ne jemi kundër kësaj.

Ilir Beqaj – Do të vijë dikush këtu, për shembull, ndonjë ambasador i BE-je, që do të ketë ndonjë importues europian, sepse kështu bëjnë këtë punë dhe fillojnë nga ministri te ministri do të vijnë te Shalsi e kështu me radhë. Ky është problemi i parë që kemi. Nuk na lejohet të krijojmë disbalanca shumë të mëdha për sa kohë MSA-ja zgjat disa vite, mund ta keni pak të disbalancuar, por nuk mund ta kem 1 me 100, do na bëjnë presion gjithnjë dhe më të tepër.

Me shpresë, me aq sa dëgjuam edhe mbrëmë ministrin e Jashtëm, në qershor mund të na japin përsëri ndonjë fjalë të mirë dhe po na dhanë ndonjë fjalë të mirë në qershor, ky presion do të na rritet gjithmonë dhe më tepër.

Me aq sa kuptova, Visar, praktikisht ti thua se ligji që është në fuqi nuk zbatohet, nuk merr mbrapsht rimbursimin e TVSH-së. Ne e dimë se ligji e ka, ministri i Financave çdo vit thotë se e rimbursion TVSH-në, por gjithmonë i ngelen nga 20% në vit pa shlyer dhe gjithmonë ka një lloj vonese. Kurse ti e ke hallin se po t'i shtosh edhe këtë në eksport, me një propozim që ne e kemi arritur të përpilojmë këtu në komision, sepse nuk ishte në draftin e parë, që edhe kur ti të eksportosh, do të shkosh atje dhe do të thuash se kaq prodhim ke bërë, është kollaj të matet ky prodhim se sa granulatat ka pasur nevojë, sa taka ke paguar dhe të marrësh taksa mbrapsht. Pra, më tepër shqetësimi është për mekanizmin e rimbursimit se sa te thelbi.

Ndërsa, në lidhje me faktin që e ka apo nuk e ka asnjë vend taksimin e lëndës së parë, kjo është e vërtetë, por praktikisht ka një ndjeshmëri më të madhe për plastikën dhe ndikimet që kanë në mjedis. Taksat e mjedisit, janë taksa që përgjithësisht në një formë apo në një formë tjetër të gjitha vendet i kanë të zhvilluara.

Po bëj një pyetje: nëse ti do të kishe eksperiencë pozitive dhe garanci që rimbursimin e merrje mbrapsht në krye të dy muajve, a do të kishe shqetësim?

Visar Rexhepi – Patjetër, po.

Ilir Beqaj – A mund të ma thuash pse?!

Visar Rexhepi – Patjetër, sepse mbi 20% e TVSH-së që na ngelet në arkat e shtetit, sepse jemi edhe prodhues, edhe importues, do të na ngelet edhe një vlerë tjetër, që është 16% dhe 20%, në bazë të llogarive tona, dhe na shkojnë mbi 40% rimbursime.

Ilir Beqaj – Thashë, në qoftë se do t'i marrësh rimbursimet rregullisht, nëse ke eksperiencë që i merr investimet rregullisht.

Visar Rexhepi – Përsëri është një investim që unë pas 2 muajsh i marr lekët.

Ilir Beqaj – Kostoja e parasë për dy muaj, këtë e ke shqetësim

Visar Rexhepi – Koston po, por kam edhe problemin se paguaj interes, kam një kredi bankare, që muaj për muaj qarkulloj lekë.

Ilir Beqaj – Shqetësimi yt është kostoja e parasë në 2 apo 3 muaj?

Visar Rexhepi – Problematika jonë si prodhues është kjo: në qoftë se unë prodhoj tasin e kosit dhe kosi që vjen nga importi nuk pagan akcizë, ndërkohë në qoftë se prodhoj tasin për kosin, që është njëpërdorimsh, do të paguaj akcizë. Ky për mua është penaltitet qoftë për mua, si prodhues i tasit të kosit, qoftë edhe për prodhuesin që e prodhon kosin.

Ilir Beqaj – Kur ti e prodhon sot tasin e kosit, a taksohet ai sot me taksë ambalazhi?

Visar Rexhepi – Aktualisht, nuk prodhoj, por, në qoftë se do të prodhoja do të taksohesha, ashtu siç është edhe importi. Problemi është se pse nuk i vini taksë edhe kosit, që është i importuar për ambalazhin që ka.

Ilir Beqaj – Kosit nuk i vëmë taksë mjedisi, por ka taksë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Çdo produkt ka taksë në ambalazhim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Kur të prodhosh këtë shishen për t'ia dhënë një prodhuesi, për t'ia çuar Qafështamës, ajo ka taksë ambalazhi...

Visar Rexhepi – Normalisht edhe unë do ta paguaja taksën e ambalazhit.

Ilir Beqaj – Me ligjin e ri kjo nuk do të ketë më taksë ambalazhi, por vetëm taksë kur ka hyrë lënda e parë, jo kjo si produkt.

Fillimisht do të ulet kostoja e ujit brenda Shqipërisë, sepse për këtë një pjesë të mirë të kostos e zë ambalazhi, nuk e zë uji.

Eduard Shalsi – Pra nuk paguhet më 100, por 35.

Ilir Beqaj – Dhe ky ujë, për pasojë, për të gjithë shqiptarët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullent, kjo ka lidhje me ekonominë, jo me shqiptarët dhe duhet ta shohim të gjithë bashkë. Në qoftë se nga i gjithë konsumi i ujit në Shqipëri na ngelet në lekët e shqiptarëve shumë më shumë lekë, i çojmë diku tjetër.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Kam një pyetje për zotin Beqaj. Ai bëri një panoramë të rastit dhe e ndau në dy pjesë: pjesën e prodhimit në vend dhe pjesën e eksportit. Supozojmë se funksionon mirë pjesa e rimbursimit në eksport, ndërkohë ai bëri llogari që për shkak të vendosjes së kësaj vlere në lëndën e parë prodhimi vendas do ta rrisë koston me 12,5% dhe, nga ana tjetër, ne themi që duhet të nxisim prodhimin vendas, por problemi është se ai grupi që do të vijë këtu thotë se në qoftë se prodhimi rritet me 12,5% ata falimentojnë, sepse produkti serb ka energjinë më të lirë, nuk tarifohet lënda e parë dhe këta do të zëvendësohen nga ai lloj produkti, si: spinat, prizat, karriget e të tjerë do të zëvendësohen me prodhime atje dhe nuk do të favorizohet prodhimi vendas. A është e justifikuar kjo?

Ilir Beqaj – Besnik, edhe ai malli që do të vijë rishtas nga Serbia, i cili deri sot nuk taksohej, sot do të taksohet. Pra, nuk e prish kjo konkurrencën, sepse prizës i rritet kostoja 12%, por edhe priza serbe, që deri sot nuk tatohej, do të tatohet, sepse është te kodi 39.

Eduard Shalsi – Sa do ta ketë?

Ilir Beqaj – Aq sa e ka, 35.

Besnik Baraj – A është thënë aty?

Ilir Beqaj – Besnik, çdo produkt i kodit 39, i cili ka 6 shifra mbrapa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Për sa i përket rimbursimit të TVSH-së, nuk e kanë vetëm ata, por të gjitha bizneset shqiptare. Kjo do të hiqet kur të vijë momenti, sepse realisht dhe ligjërisht TVSH-ja nuk duhet të merret në doganë, por kur shkon te konsumatori dhe këtë nuk e zgjidhim ne sot.

Ilir Beqaj – Unë kam një shqetësim. Në zbatimin e këtij, unë them se kështu siç është shkruar përmbajtja duhet të ndërrohet edhe titulli i nenit, sepse kemi ngelur tek taksa e ambalazhit, pasi vjen inspektori dhe thotë se titulli është në ambalazh dhe nuk më duhet se çfarë është kjo. Prandaj titulli duhet të jetë në taksën e plastikës, sepse vetë përmbajtja ka dalë mbi ambalazhin.

Vullnet Sinaj - Unë duhet ta nis fjalën time nga dokumenti i buxhetit, i cili na ka ardhur këtu. Te zëri i të ardhurave kemi një të ardhur që është 100 miliardë lekë nga TVSH-ja

në doganë dhe, në një farë mënyre, ne mburremi me këtë, por kjo nuk është për t'u mburrur. Po të mendosh që në doganë mbledhen 100 miliardë TVSH, do të thotë se 500 miliardë lekë dalin nga xhepat e shqiptarëve dhe ikin jashtë. Po ta shikojmë nga krahu i tjetër, kjo tregon se 500 miliardë janë të gjitha shpenzimet e buxhetit për vitin 2019, që do të thotë se boshatisim, hapim një gropë dhe e rimbushim prapë këtë gropë. Kjo është e vetmja mënyrë që ta mbajmë gropën sa më pak të hapur, prodhimin vendas. Unë nuk merrem me MSA-në, sepse MSA-ja duhet të ishte e barabartë për të gjithë Ballkanin: për Serbinë, për Bosnjën, për Maqedoninë dhe për Malin e Zi. Në qoftë se të gjithë ata e kanë zero, edhe ne zero duhet ta kemi, sepse ne nuk funksionojmë vetëm për tregun shqiptar, por bëhet fjalë për një treg më të madh, një treg ballkanik. Ne duhet të themi shyqyr Zotit dhe bravo u qoftë bizneseve shqiptare që kanë arritur të kalojnë kufijtë e tregut shqiptar dhe të dalin të shesin në Ballkan. Në qoftë se flasim për dritën jeshile që duam t'u ndezim shqiptarëve, është ajo dritë që ata të shikojnë të ardhmen dhe të mos largohen nga ky vend. Kështu që unë nuk diskutoj as MSA-në dhe asgjë. Në këtë rast bëhet fjalë për një taksë të lëndës së parë, e cila rrit koston e prodhimit shqiptar, të cilin, në çfarëdolloj mënyre që t'ua bëjmë, ne nuk eksportojmë dot. Pse duhet t'i krijojmë ne vështirësi dhe të mos e lëmë të lirë të punojë?! Unë jam absolutisht kundër kësaj takse. Le të ekzistojë taksa për ambalazhin dhe le të jetë edhe 100 lekë siç ishte, por taksa për lëndën e parë nuk duhet të rritet, lereni siç është taksën për ambalazhin, pasi tregu është stabilizuar dhe të gjitha bizneset janë ambientuar me këtë taksë. Mos e lëvizni prodhimin vendas!

Sa punëtorë ke, Visar?

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Gjynah, sepse unë e di që Visari do të ikë direkt në Maqedoni, ku taksën e ka zero, do të marrë ndërmarrjen me 1 milionë euro, do t'u japë maqedonasve dhe do të investojë atje, do të lëvizë edhe katër punëtorë dhe shqiptarët tanë do të shkojnë të investojnë jashtë. Mos e bëni këtë shaka!

Faleminderit!

Besnik Baraj –Kur negociohej MSA-ja, edhe unë kam qenë pjesë e saj. MSA-ja negociohej në mënyrë bilaterale, bëhej edhe për Shqipërinë dhe një nga problemet e Shqipërisë, qoftë për OBT-në, qoftë për këtë ka qenë që ne kemi rendur dhe jemi treguar të pamatur në negociim, duke penalizuar prodhimin vendas. Biznesi në atë periudhë ka kundërshtuar, por qeveritë e asaj kohe e quanin sukses, në një kohë kur partnerët tanë kroatë, sllovenë dhe serb na thoshin.... Serbia gjithmonë ishte më e ngadalta, rezistonte në negociim, sepse nuk donte të penalizonte prodhimin vendas dhe këto negociata ne i kemi pranuar, janë shkruar e zeza mbi të bardhë dhe tani ndodhemi para këtij fakti, ku ajo kthehet në ligj dhe ky

është problemi. Sot i takon qeverisjes së sotme ta zgjidhë sesi duhet të negociojë për t'i zbutur ato, sepse praktikisht ato janë detyrime ligjore për Shqipërinë.

Eduard Shalsi – Kjo që thotë Beqaj për taksën e ambalazhit, sepse vetëm kësaj pike po i referohemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullent, së pari, sot që flasim duhet të dimë se sa visarë kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Sa të duash” është një fjalë që duhet ta thotë ai atje, por neve na takon....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk mund të shkojmë me hamendësime dhe nuk mund të marrim vendime mbi një informacion të cunguar, sepse ne nuk e dimë se çfarë pasojash prodhojmë.

Ne kemi dëgjuar disa grupe interesi dhe na duhet të konsolidojmë një bindje, ku gjëja më e lehtë është ta lëmë siç ishte, por, nëse na duhet ta ndryshojmë dhe nëse nuk duhet ta afektojmë industrinë, a ka një opsion tjetër?

Edhe unë jam plotësisht dakord, sepse në këtë fazë nuk është se na detyron njeri të na imponohet për disa masa që burojnë nga marrëveshja. Jo, ne ishim në Çeki dhe një nga porositë që na është dhënë është që të jemi shumë kujdesshëm kur negociojmë, sidomos për të mbrojtur prodhimin vendas, deri sa të vijë laku në fyti, sepse në një moment ose një tjetër sigurisht që do të dorëzohemi, pasi do të bëhemi pjesë e një komuniteti që ka rregullat e tij, por që duhet të shtyjmë sa më shumë disa masa, të cilat afektojnë biznesin vendas. Parimisht patjetër që jemi dakord të mbështesim prodhimin vendas.

Nga ana tjetër, unë jam akoma i paqartë për pjesën e kësaj që ne po i referohemi, taksës së ambalazhit plastik, ku ndërkohë ne nuk po flasim vetëm për ambalazhin.

Ilir Beqaj – (mungesë dëgjimi) Ankohen importuesit e produkteve të ndryshme, të cilët thonë se industria vendase ushqimore, në dy vjetët e fundit, ka ngritur problematikën e rishikimit të kësaj takse me arsyetimin se taksa e ambalazhit plastik në importin e tij paguhet e plotë, taksa e ambalazhit plastik, prodhim vendi ka problem, pasi prodhuesit vendas nuk e deklarojnë ambalazhin plastik, i cili ka taksë 100 lekë për kilogramë, por deklarojnë fiktivisht prodhime të tjera joplastike, të cilat nuk taksohet me këtë ambalazh dhe mosdeklarimi i ambalazhit në prodhim vendi sjell evazion zinxhir te prodhuesit e ujit, lëngjet dhe prodhimet e tjera ushqimore të vendit që ambalazhohen me ambalazh të padeklaruar.

Eduard Shalsi – Pra ekziston një problem i tillë, por si adresohet ky problem, sepse kjo masë...

Visar Rexhepi – Për çështjet e ambalazhit. Prodhuesit vendas që prodhojnë ambalazhe, prodhim pipete nuk prodhon dot, sepse nuk ekziston në Shqipëri, por bëhet nga Bullgari. Unë jam personi i parë që e kam menduar investimin për makineri pipetash. Për fryrjen, që bëhet bidon, çdo fabrikë e ka të veten...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fryrje është.

Ilir Beqaj -Fryrja nuk është prodhim.

Visar Rexhepi – Të thuash që këtu ka prodhues, të cilët e prodhojnë kontrabandë është komplet fiktive dhe evazive, sepse nuk është e vërtetë, pasi unë njoh edhe prodhuesit më të mëdhenj të ujërave të Shqipërisë dhe e them me bindje të plotë se pipetën e sjellin nga Bullgaria. Prodhim aktual të brendshëm për plastikë ka shumë pak. Problematika kryesore është plastika që përdorin, sepse në shumicën e rasteve nuk është lëndë e parë që importohet, por një lëndë e parë që gjendet këtu, një mënyrë riciklimi i versionit tonë që nxjerrin mall, që nuk janë standarde. Për mendimin tim, kjo është më shumë shqetësuese sesa evazioni fiskal që mund t'i bëjnë këto minipunishte që ndodhen në rrethe shumë të largëta të Shqipërisë.

Ilir Beqaj – Unë mendoj që, nëse e kemi të mundur të kontaktojmë për të provuar sa i vërtetë është ky shqetësimi i prodhuesve vendas ushqimor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ambalazhin që përdorin për shishet që mbushen me komposto, salcë e të tjerë. Në qoftë se mundemi që deri nga fillimi i javës tjetër të gjemë ndonjë të dhënë... Sepse janë ankuar këta, që ka lindur kërkesa për ta rishikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi –Të ftuarit e drekës janë prodhues të plastikës.

Ilir Beqaj – Ose mund të pyesim Ministrinë e Financave se kush është ankuar dhe t'i gjejmë.

Vullnet Sinaj – Ne po merremi me atë që Ministria e Financave ka sjellë mënyrën sesi e justifikon vendosjen e kësaj takse. Ministria e Financave ka sjellë rekomandime për të hequr akcizën te fishekzjarrët dhe është këtu për të tërhequr vëmendjen. Domethënë sjell fishekzjarrët për t'u hequr akcizën dhe lëndës së parë i vëmë akcizën. Kjo është anormale.

Eduard Shalsi – Sa ishte e ardhura e akcizës nga fishekzjarrët?

Pasi u kontaktua me doganat, ishte propozimi i tyre që thanë se vendet e rajonit e kanë taksën zero dhe e kemi të pamundur ta kontrollojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga njëra anë thamë që ta bëjmë të njëjtë me rajonin, por ai e ka zero taksën e fishekzjarrëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Visar Rexhepi – Lidhur me taksën zero, edhe për llambën e vjetër, që ka qenë një herë e një kohë, rajoni e ka pasur taksën zero dhe aktualisht të gjitha llambat që hyjnë në Shqipëri janë 99% kontrabandë, kjo për shkak të vendosjes së taksave të pa sens që vëmë ne. Kemi vënë 120 lekë taksë për llambën e thjeshtë dhe e gjitha futet kontrabandë. Ne kemi qenë një nga importuesit më të vjetër të llambës dhe aktualisht nuk importojmë më shumë se 3-4% në të gjithë tregun, nga një treg që kishim 60-70%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithmonë e më pak në xhiro, por që jemi gjithmonë e më larg nga tregu.

Vullnet Sinaj – Visar, kë do që të heqim, taksën për lëndën e parë të plastikës apo taksën e importit të llambave?

Visar Rexhepi– Të dyja janë të gabuara.

Vullnet Sinaj – Cila është më mirë që të hiqet?

Visar Rexhepi – Sigurisht që plastika, sepse aty kam edhe punonjës.

Eduard Shalsi – Atëherë, nëse nuk ka diçka tjetër për të shtuar, në orën 15:00 takim me grupin e interesit. Vullnet, njofto atë në orën 15:00!

Elona, njoftoi të tjerët për takimin në orën 15:00!

Javën tjetër do të kemi një dëgjese me grupin e interesit, që është ankuar për taksën.

Zoti Beqaj, javën tjetër duhet t'i mbyllim diskutimet, por duhet të kesh parasysh se mbledhjen në datën 23 e kemi në parkun Jabllanicës.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit, Visar, do të mbetemi në kontakt!

MBYLLET MBLEDHJA